



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01.	07.01.24	Kërkesë për informacion mbi kriteret për përfitimin nga Fondi 6%	08.01.24	<p>Lidhur me kriteret për përfitim nga fondi i kushtëzuar deri në 6%, për ndihmën ekonomike sqarojmë se, bazuar në VKM-në Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu IV, pika 1 përcakton se:</p> <p><i>“Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.</i></p> <p>Sipas pikave 5 dhe 7 të po këtij Kreu përcaktohet se, Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese të cilat në momentin që do të përzgjidhen nga lista e familjeve:</p> <ul style="list-style-type: none">-Duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar,-Të mos jenë shpallur përfituese nga sistemi i	E plotë	Nuk ka



				<p>pikëzimit,</p> <p>-Duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administratori shoqëror.</p> <p>Nëse gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6%, Administratori shoqëror verifikon që ka ndryshime të situatës social ekonomike, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.</p>		
02.	08.01.24	Kërkesë për informacion mbi shërbimet që ofrohen në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Trafikimit	18.01.24	<p>Shërbimet që ofron Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit janë shërbime rehabilituese të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strehim, ushqim dhe veshmbathje • Strehim të lartë sigurie • Asistencë mjekësore • Asistencë psikologjike • Asistencë ligjore • Program mësimdhënie, nga specialistë edukator. • Asistencë psiko-sociale dhe suport emocional • Përgatitje për riintegrim dhe jetë të pavarur • Kurse profesionale <p>Çdo rast që trajtohet në qendër merr të gjitha shërbimet sipas një plani kujdesi që hartohet nga menaxhuesi i rastit bazuar në nevojat e referuara nga rasti.</p>	E plotë	Nuk ka
Gjatë muajit Shkurt 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion.						
03.	04.03.24	Kërkesë për informacion	14.03.24	Numri i personave që trajtohen me pagesë të aftësisë	E plotë	Nuk ka



		mbi numrin e PAK që trajtohet me pagesë të AK, filtrat e vlerësimit, abuzimet etj.		<p>së kufizuar dhe shpërndarja gjeografike në të gjithë Shqipërinë është publik në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror në ëeb ëëë.shërbimisocial.gov.al, në rubrikën raporte.</p> <p>Lidhur me filtrat e vlerësimit, personat aplikues për Statuset e Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë komisionohen nga KMCAP-et e përbërë nga mjekë specialistë të fushave përkatëse, ndërsa për personat e tjerë të cilët hyjnë në kategorinë PAK mendor dhe fizikë komisionimi kryhet nga komisionet bio-psiko-sociale të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (të përbërë nga mjekë dhe punonjës socialë) të cilët janë të vendosur pranë vendbanimit të qytetarëve. Pas vlerësimit qytetarët njoftohen zyrtarisht për vendimmarrjen përmes njësisë administrative ku banojnë.</p> <p>Lidhur me interesimin tuaj për abuzimet ju sqarojmë se qytetarët paraqiten për vlerësim të aftësisë së kufizuar me një dosje të plotë dokumentacioni mjekësor të plotësuar nga stafet mjekësore, ku konfirmohet diagnoza dhe mbështetet nga ekzaminimet përkatëse. Vendimmarrja e komisioneve bazohet në kritere të përcaktuara me ligj,gjë e cila shmang abuzimet dhe garanton se nuk ka persona që mbeten të pambështetur nga politikat sociale.</p>		
04.	04.03.24	Kërkesë për informacion lidhur përfitueset kryefamiljare nga Programet e Mbrojtjes	11.03.24	1.Në VKM-në Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore tëpërfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e	E plotë	Nuk ka



		<p>Sociale, kriteret, përfitimet etj.</p>	<p>kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu III, nëpikën 16 përcaktohet se: “Familjet përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje tre apo më shumë fëmijë të moshës 0–18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes” ku brenda kësaj kategorie përfshihen edhe gratë kryefamiljare, pika 16/1 ku përcaktohet se: “Gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërjen e tyre deri në dy fëmijë të moshës 0-18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes”.</p> <p>Të gjitha familjet përfituese nga programi i ndihmës ekonomike përveç pagesës mujore të ndihmës ekonomike marrin përfitimet tjera shtesë si më poshtë:</p> <p>a) Kompensimi i Energjisë Elektrike në masën 1288 lekë sipas VKM-së Nr.8, datë 14.01.2015 dhe VKM-së Nr.565, datë 09.08.2006.</p> <p>b) Vendosjen e matësve të ujit dhe lidhjen e kontratës së ujit pa pagesë sipas VKM-së Nr.18, datë 12.01.2018.</p> <p>c) Përjashtim nga tarifa e studimit në Universitet dhe Bursëshkollimi në masën 10.000 lekë për çdo fëmijë.</p> <p>d) Subvencion për arsimin e detyrueshëm në masën 300 lekë për çdo fëmijë/tekstet shkollore falas për arsimin e detyrueshëm.</p> <p>e) Çerdhe dhe kopsht falas për fëmijët e familjeve në</p>		
--	--	---	---	--	--



				<p>nevojë.</p> <p>f) Vizitë mjekësore falas/Rimbursim i ilaçeve për familjet nënevojë.</p> <p>g) Subvecion për çdo vaksinë të kryer për fëmijët në masën 100 lekë.</p> <p>h) Subvencion strehimi/ Bonus qeraje për familjet në nevojë.</p> <p>i) Punësim dhe formim profesional për familjet në nevojë të cilët kanë anëtarë në moshë aktive pune, në bashkëpunim me AKPA-në.</p> <p>j) Përjashtim nga tarifat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për familjet në nevojë.</p> <p>Gjithashtu në VKM-në Nr. 751, datë 01.12.2022 “Për njëmbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”, pika 1 përcaktohet se: “Gratë të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100.000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqëriedhe barrë lindjeje.</p> <p>2. Lidhur me numrin e grave me tre fëmijë që kanë përfituar nga programet e mbrojtjes sociale, nga të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar rezulton se përfitojnë ndihmë ekonomike 15.000 familje të cilat kanë tre ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç si dhe 7024 familje me gratë të papuna të cilat kanë tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>3.Lidhur me kriteret për të përfituar nga programet e mbrojtjessociale sqarojmë se:</p> <p>Në VKM-në Nr. 597/2019 “Për përcaktimin e procedurave, tëdokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmësekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2 përcaktohetse përfitojnë ndihmë ekonomike familjet në nevojë të cilat nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.</p> <p>Në VKM-në Nr. 751, datë 01.12.2022 “ Për një mbrojtje tëveçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumëfëmijë të moshës deri në 18 vjeç” si dhe Udhëzimin Nr.670, datë13.12.2022 ‘Për procedurën e aplikimit dhe përfitimit ngaprogrami i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”, nëpikën 1 janë përcaktuar kriteret për të qenë përfituese nga kyprogram si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gratë e papuna, ekonomikisht jo aktive - Me tre apo më shumë fëmijë deri në 18 vjeç,ku njëri prejfëmijëve është nën moshën 5 vjeç - Familja ka të ardhura nën 100.000 mijë lekë bruto në muaj. <p>4.Lidhur me afatet e aplikimit të programeve të mbrojtjes sociale të cilat lidhen me dyfishimin masës së ndihmës ekonomike përgratë kryefamiljare si dhe</p>		
--	--	--	---	--	--



				<p>VKM-në Nr. 751/2022 sqarojmë se:</p> <p>a) Dyfishimi i masës së pagesës ekzistuese të ndihmësekonomike për gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërjen e tyre deri në dyfëmijë të moshës 0-18 vjeç, ka filluar të zbatohet prej muajit Tetor 2022 me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr. 617, datë 22.9.2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 597, datë 4.9.2019, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar.</p> <p>b) Programi për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeçka filluar të zbatohet prej muajit Janar 2023 me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr. 751, datë 01.12.2022 “ Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”.</p>		
Gjatë muajit Prill 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion.						
Gjatë muajit Maj 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion.						
5.	13.06.24	Kërkesë për informacion nëse ekziston ndonjë Departament ose njësi brenda SHSSH që mbështet viktimat e dhunës dhe viktimat e	14.06.24	Shërbimi Social Shtetëror kryen monitorimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës, dhe shërbime të tjera sociale. Ndërsa bazuar mbi Ligjin nr 121 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror në RSH” menaxhimin e rasteve të dhunës e realizon koordinatori vendor i dhunës pranë çdo njësie	E plotë	Nuk ka



		dhunës me armë specifikiht.		administrative/bashkie.		
6.	18.06.24	Kërkesë për informacion lidhur me numrin e PAK në Shqipëri	18.06.24	Numri i personave me aftësi të kufizuar është 72.711 në periudhën Mars-Prill 24.	E plotë	Nuk ka
7.	2.7.24	Kërkesë për informacion lidhur me disa çështje të ndryshme të Programeve të Mbrojtjes Sociale.	16.7.24	<p><i>Sa është numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Referuar mesatares vjetore ka 62,399 përfitues të skemës NE (familje NE dhe përfitues të kategorive të veçanta). Ndarjen e përfituesve në meshkuj dhe femra nuk e disponojmë si të dhënë.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2023? Sa janë femra dhe meshkuj?</i></p> <p>Nuk e zotërojmë si të dhënë.</p> <p><i>Sa është numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Numri mesatar i përfituesve të PAK për vitin 2023 është 72,474 persona. Nuk e disponojmë sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Nuk e disponojmë këtë të dhënë.</p> <p><i>Sa është numri total i përfituesve që janë pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Numri total i përfituesve të shërbimeve sociale janë 14,840 (përfshihen përfitues të të gjitha shërbimeve ditore, rezidenciale, publike & jopublike. Nga numri</p>	E plotë	Nuk ka



			<p>total i përfituesve të shërbimeve sociale 8,427 janë femra.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) që janë përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror? Sa prej tyre janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Nuk e disponojmë këtë të dhënë.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) që janë pjesë e skemave të mbrojtjes sociale për vitin 2023?</i></p> <p>Nuk kemi informacion zyrtar mbi këtë pikë.</p> <p><i>Sa është numri total i personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri në vitin 2023 (duke përfshirë PAK mendor/Fizik, paraplegji dhe verbëri)?</i></p> <p>Numri mesatar i përfituesve të aftësisë së kufizuar për vitin 2023 është 72,474 persona.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) (duke përfshirë PAK mendor/Fizik, paraplegji dhe verbëri) për vitin 2023?</i></p> <p>Nuk kemi të dhëna sipas grup-moshave.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve vulnerabël (15-29 vjeç) të punësuar me anë të programeve të nxitjes së punësimit gjatë vitit 2023? Sa janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Nuk është e dhënë që administrohet nga SHSSH.</p> <p><i>Sa është numri i të rinjve vulnerabël në punë në vitin 2023? Sa janë meshkuj dhe femra?</i></p> <p>Nuk është e dhënë që administrohet nga SHSSH.</p> <p><i>Sa është buxheti i shtetit në dispozicion për programet e mbrojtjes sociale në vitin 2023?</i></p> <p>Buxheti i shtetit në dispozicion për programet e mbrojtjes sociale për vitin 2023 ka qenë 30,597,119,000 lekë.</p> <p><i>Sa janë shpenzimet totale për programet e mbrojtjes</i></p>		
--	--	--	---	--	--



				<p><i>sociale për vitin 2023?</i> Shpenzimet totale per vitin 2023 kane qene 30,095,419,629 leke (Fakt).</p>		
8.	9.07.24	Kërkesë për informacion lidhur me disa çështje të AK	21.7.24	<p>- Vlerësimi i shërbimeve sociale të ofruara nga Fondi Social dhe IPSH-te Lidhur me këtë pikë ju sqarojmë se Shërbimi Social Shtetëror nuk ka asnjë IPSH për personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë e Tiranës. Nga ana tjetër, deri në përfundim të vitit 2023 nuk ka pasur shërbime për PAK të financuara me anë të Mekanizmit të Fondit Social. Në vitin 2024 është financuar me Fond Social shërbimi “Asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuar në zonat rurale të Bashkisë Tiranë”, shërbim i cili nuk është monitoruar ende nga ana e Shërbimit Social Shtetëror.</p> <p>2. Informacion në lidhje me kontrollin e shërbimeve në Bashkinë Tiranë (11 shërbime)</p> <p>- Sigurimi i Cilësisë së Shërbimeve Shoqërore Shërbimi Social Shtetëror, lidhur me këtë pikë ju sqaron se vlerësimi i cilësisë së shërbimeve shoqërore për të gjitha shërbimet shoqërore të ngritura në Bashkinë Tiranë kryhet nga Inspektorati I punës dhe Shërbimeve Shoqërore.</p> <p>- Informacion në lidhje me rishikimin e standardeve të shërbimeve rezidenciale dhe ditore për PAK dhe kostimi i shërbimit MSHMS, në bashkëpunim me Programet</p>	E Pjesshme	0



			<p>mbështetëse të BE, GOPA, prej vitit 2023 ka nisur procesin e rishikimit të standardeve të shërbimeve sociale për të gjitha target grupet, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar, proces i cili është në vazhdimësi.</p> <p><i>- Informacion në lidhje me kontrollin e skemës të vlerësimit të ri bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Tiranë, metodologjia e kontrollit të vlerësimit Bio-Psiko-Social</i></p> <p>Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror kryen dy kontrole të plota në muaj sa i përket Aftësisë së Kufizuar, pranë njësisë Administrative apo bashkive, sipas planit vjetor të kontroleve, bazuar në legjislacion, edhe kontrole të paprogramuara bazuar vlerësimit të riskut apo ankesave të ndryshme. Në linkun e mëposhtëm gjeni Metodologjinë e Vlerësimit të Skemës së Vlerësimit Bio-Psiko-Social të AK:</p> <p>https://ëëë.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2021/05/metodologjia-e-kontrollit-te-vleresimit-biopsikosocial-te-aftesise-se-kufizuar.pdf</p> <p><i>- Informacion në lidhje me shqyrtimin/ vlerësimin e ankesave të ardhura në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, për bashkinë Tiranë</i></p> <p>Pranë Shërbimit Social Shtetëror funksionojnë 3 Komisione për Shqyrtimin e Ankesave. Të dhënat e disponuara nga KSHA janë për Qarkun e Tiranës.</p>		
--	--	--	---	--	--



			<p>Konkretisht: Gjatë vitit 2023 – 718 ankesa, të gjitha të shqyrtuara Për vitin 2024 deri më muajin Korrik 2024 – 401 ankesa nga të cilat janë shqyrtuar 250 ankesa.</p> <p>3. Regjistri Elektronik i Aftësisë së Kufizuar - Informacion në lidhje me përditësimin e arkivës elektronike midis Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale SHSSH, Tiranë Arkiva Elektronike e PAK përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror përditëson rregullisht në sistem vendimmarrjen e KMCAp-eve të Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë të cilat janë rikomisionime dhe raste të reja.</p> <p>4. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet - <i>A është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis Bashkisë së Tiranës dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë?</i> Shërbimi Social Shtetëror ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale në kuadër të zbatimit të reformës së aftësisë së kufizuar. 6 KVSHAK rekomandojnë shërbime sociale për PAK që vlerësojnë dhe këto të fundit ndiqet për marrjen e shërbimeve nga pushteti vendor. - <i>Informacion në lidhje me koordinimin e procesit të integrimit social të përfituesve PAK në moshë</i></p>		
--	--	--	---	--	--



				<p><i>aktive pune, nëpërmjet referimit drejt skemave të punësimit dhe formimit profesional, Bashkia Tiranë.</i></p> <p>Shërbimi Social Shtetëror ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me AKPA-n për integrimin e PAK nëpërmjet punësimit ose programeve të formimit profesional. Në këtë kuadër, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror përcjell pranë Drejtorisë Rajonale të në mënyrë periodike rekomandimet e KVSHAK për shërbime punësimi ose formimi profesional. Skedat plotësohen nga administratorët shoqërore pranë njësive administrative sipas profilit social-ekonomik si edhe mundësive të personave.</p> <p>Të dhënat e disponueshme janë për Qarkun Tiranë, ku gjatë vitit 2023 janë punësuar 127 persona me AK dhe kanë ndjekur formim profesional 20 persona me AK. Për vitin 2024 deri më Qershor 2024 janë punësuar 152 persona.</p>		
Gjatë muajit Gusht 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion.						
Gjatë muajit Shtator 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion.						
9.	28.10.24	Kërkesë për informacion lidhur me QKTE, numrin e përfituesve, kohëzgjatjen e qëndrimit në qendër, etj.	01.11.24	<p>Në qendër janë të strehuar 33 – familje Rome/Egjiptiane në total (prej tyre 18 familje të komunitetit Rom dhe 15 familje të komunitetit Egjiptian).</p> <p>Qëllimi i kësaj qendre është t’ju vijë në ndihmë individëve dhe familjeve në situatë emergjence për shkak të fatkeqësive natyrore apo kushte të rënda social – ekonomike, dhe që vijnë nga grupe të ndryshme shoqërore pa dallim gjinie, seksi, race, gjuhe, feje etj.</p>	E plotë	0



			<p>Kohëqëndrimi i këtyre familjeve sipas standardit nr.3.6 është 3-6 muaj dhe në një vit për raste specifike. Por ndryshe nga koha e përcaktuar në standardet e miratuara, qëndrimi i familjeve ka shkuar deri në disa vite. Kjo për arsye se familjet nuk dëshirojnë të largohen edhe pse ju është ofruar gjithë ndihma dhe mbështetja e nevojshme nga punonjësit social të qendrës. Banorët hezitojnë të largohen nga qendra pasi shumica e tyre nuk kanë një punë stabil si dhe kanë vështirësi për të gjetur banesë me kontratë afatgjatë.</p> <p>Familjet pas daljes nga qendra duhet të përfshihen në Programet e Strehimit dhe nxitjes së punësimit që ofrohen nga Bashkitë siç janë; Bonus qeraje dhe Banese Sociale. Vlen të theksohet se është bërë përpjekje e vazhdueshme me banorët që të mbështeten me Bonus Qeraje si dhe të informohen dhe regjistrohen në zyrat e punës.</p> <p>Janë bërë disa shërbime mirëmbajtje emergjente minimale si: elektrike, hidraulike, lysterje të godinave, riparim, duralumin.</p> <p>Nuk është bërë asnjë ndërhyrje në godinat e banimit edhe pse ato kanë patur dëmtime si nga tërmeti ashtu edhe nga lagështira. Investimi i tyre ka qënë që në fillim kur janë hapur si shërbim i ri, dhe nuk ka patur investim të ri. Vihet re amortizimi i tyre dhe mungesë e mirëmbajtjes nga banorët.</p> <p>Kriteret për pranimin e familjeve në QKTE janë përcaktuar në VKM Nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre”</p>	
--	--	--	---	--



			<p>Shërbimi për të pastrehët, sipas përcaktimit të pikës 9, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere: a) Të jenë mbi 18 vjeç e të pastrehë; b) Të jenë përfitues të ndihmës ekonomike ose në proces aplikimi për ndihmën ekonomike.</p> <p>Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon: a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes; b) Fotografinë e individit (2 copë); c) Raportin nga komisioni mjekoligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit; ç) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile; d) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; dh) Verifikimi i aplikimit për ndihmë ekonomike ose për përfitimin e ndihmës ekonomike; e) Informacion mbi pasuritë e paluajtshme nga regjistri i ZRPP-së.</p> <p>Familjet që referohen për akomodim pranë qendrës janë familje të cilat gjenden në situatë rruge dhe vështirësi të theksuara socio-ekonomike.</p> <p>Njësia përkatëse, Punonjësi Social në drejtoritë sociale të Bashkisë merr informacionin e nevojshëm për familjen/Individ, kryen vlerësimin për situatën emergjente në të cilën ndodhet familja më pas referohet për shqyrtim pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë.</p> <p>SHSSH shqyrton kërkesën dhe vendos për</p>	
--	--	--	--	--



				<p>pranimin. ose jo , në varësi të vlerësimit për sistemim në QKTE me shkresën përkatëse.</p> <p>Individi/ familjet që strehohen pranë qendrës duhet të jenë të aftë tu shërbejnë vetes dhe familjes me ushqim, gatim, higjenë.</p>		
Gjatë muajit Nëntor 2024 nuk ka pasur kërkesa për informacion						
11.	12.12.24	Kërkesë për informacion lidhur me nr. e personave me AK, pagesat e sigurimeve për ndihmësit personalë etj.	20.12.24	<p>Personat me aftësi të kufizuar (73,278 total) janë të kategorizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • PAK fizik dhe mendor -53,857 persona • Para-Tetraplegji -5,723 persona • Verbëri - 13,699 persona <p>Ndihmës personalë gjatë viteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Viti 2020 – 19600 persona • Viti 2021 – 18.725 persona • Viti 2022 – 18.119 persona • Viti 2023 – 18.340 persona • Viti 2024 – 18.540 persona <p>Pagesat e ndihmësave personalë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndihmësi personal për përfituesit me status verbërie përfiton 14.388 lekë/muaj; • Ndihmësi personal për përfituesit e para tetraplegjisë përfiton 13.315 lekë/muaj; • Ndihmësi personal i herëpashershëm për personat me aftësi të kufizuar me Vlerësimin Bio Psiko social përfiton 11.652 lekë/muaj; • Ndihmësi personal gjithpërfshirës për personat me aftësi të kufizuar me Vlerësimin Bio Psiko social përfiton 17.478 lekë në muaj. 	E plotë	0



				<p>Bazuar në Vkm nr. 182, datë 26.02.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave të dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar si dhe ndihmësit personal” e ndryshuar, Kreu III, pika 8 “<i>Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilët nuk janë ekonomisht aktiv, si dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni , barrëlindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe përballohet nga buxheti i shtetit</i>”</p>		
--	--	--	--	---	--	--